



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2022:093462

Datë: 25.03.2025

Numri i dokumentit: 07039594

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.236/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Naim Rekalu, me zyrtaren ligjore Arta Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit A.S nga Vushtrria, rr. "...", nr..., të cilin sipas detyrës zyrtare e përfaqëson av. Sabit Rama, për shkak të veprës penale Mashtrimi nga neni 323 par. 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.2227/2021 të datës 08.08.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 21.03.2025, në praninë e Prokurorit të Shtetit Valon Cervadiku, të pandehurit A.S, mbrojtësit Sabit Rama dhe të dëmtuarit D.Sh, në të njëjtën datë shpalli, ndërsa me datë 25.03.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. I pandehuri : A.S, nga i ati H..., e ëma M..., mbiemri i vajzërisë R..., i lindur me datën ..., me vendbanim në Vushtrri, i martuar, baba i dy fëmijëve, tregtar, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

I. SEPSE: Në vitin 2021, në Vushtrri, me anë të paraqitjes së rreme të fakteve dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, e vënë në lajthim personin tjetër, tani të dëmtuarin D.Sh, ashtu që i pandehuri me qëllim shitje ka bërë zbritjen e kilometrave te kaluara ne "Odometer" ne automjetin e markës "VW Golf 6", tipi 1K, ngjyrë e kaltër, me vit te prodhimit 2011, me targa te regjistrimit, ..., me numër te karrocerisë WVWZZZ1KZCW132146, me qëllim që te ia ngris vlerën, dhe atë nga 304164 km, te cilat i kishte te regjistruara ne vitin

23.01.2020, ne 205716, kilometra te kaluara te cilat automjeti i posedonte ne vitin 02.03.2021, me ketë ka bere uljen e 98448 kilometrave te kaluara e cila është vërtetuar nga qendra e kontrollimit teknik QKTA “Marketing Plus,

Me këtë ka kryer veprën penale *Mashtrim* nga neni 323 par.1 të KPRK-se (Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr.06/L-074).

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 364, 449 dhe 450 të KPPK-së, të akuzuarin,

E G J Y K O N

I. ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej 1000€ (njëmijë euro), i cili dënim duhet të paguhet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se i pandehuri refuzon të paguaj dënimin me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të pandehurit për çdo njëzet (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim, si dhe

II. ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej tre (3) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Me pëlqimin e të pandehurit, e në bazë të nenit 44 të KPRK-së, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muaj i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë 1800 (me fjale: njëmijë e tetëqind) euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar të paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjukata do të veproj në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që të njëjtit, dënim më gjobë do t'i zëvendësohet më dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 (euro) gjobë të papaguar, me 1 ditë burgim.

Gjukata në mbështetje të nenit 76 të KPRK-së, të pandehurit:

I S H Q I P T O N

IV. DËNIM UNIK ME GJOBË në shumë prej 2800 euro (me fjalë: dymijë e tetëqind), të cilin dënim është i obliguar ta paguaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, dënimin me gjobë gjykata do t'ia zëvendësoj më dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do t'i llogaritet më 20 (njëzet) euro gjobë të papaguar.

V. DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumë prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumë prej tridhjetë euro (30€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

VI. Pala e dëmtuar D.Sh për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar.

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.2227/2021 të datës 08.08.2023, kundër të pandehurit A.S nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Mashtrimi nga neni 323 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 21.03.2025, në të cilën seancë ka prezantuar Prokurori i Shtetit Valon Cervadiku, i pandehuri A.S së bashku me mbrojtësin av.Sabit Rama, si dhe i dëmtuari D.Sh.

Pas leximit të aktakuzës, nga ana e Prokurorit të Shtetit, dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, si dhe sqarimit të benefiteve dhe pasojave të pranimit të fajësisë, të njëjtit i është ofruar mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë. I pandehuri A.S është deklaruar fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, gjykatës i ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, palës së dëmtuar prezentë i ka kërkuar falje, si dhe ka shtuar se është i gatshëm që t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar. Gjykatës i ka premtuar se do të jetë i kujdesshëm në të ardhmen dhe se është i gatshëm të përgjigjet për veprën e kryer.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë, pasi që pranimi i fajësisë është i vullnetshëm, pa presion, i bazuar në

provat materiale si në aktakuzë dhe është bërë pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, si dhe është në përputhje me nenin 242 të KPRK-së, andaj gjykatës i ka propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtorë, ta dënojë sipas ligjit si dhe me rastin e shqiptimit të dënimit, pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, ndërsa si rrethanë rënduese dashjen në kryerjen e veprës.

I dëmtuari lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se e përkrah fjalën e prokurorit të shtetit.

Avokati mbrojtës lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit gjykatës i ka propozuar që ta bëjë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, gjegjësisht të mbrojturit të tij, për faktin se ka vlerësuar se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është bërë në mënyrë vullnetare, pa imponim dhe pas konsultimit me të si mbrojtës, meqë pranimi i fajësisë mbështetet edhe në provat materiale në shkresat e lëndës, andaj ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet nga neni 242 i KPRK-së dhe ka propozuar që gjykata ta pranojë fajësinë nga ana e të mbrojturit të tij. Sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit gjykatës i ka propozuar që me rastin e caktimit të këtij dënimi të ketë parasysh rrethanat lehtësuese nga ana e të mbrojturit të tij, siç është pranimi i fajësisë në mënyrë vullnetare, pastaj fakti që i njëjti është person familjar, baba i dy fëmijëve, e kaluara e tij kriminale është e pastër, më parë nuk ka qenë i dënuar, pastaj premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, andaj i ka propozuar gjykatës që ndaj të mbrojturit të tij të shqiptojë një dënim sa me të butë, me të cilin në tërësi do të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se, pranimi i fajësisë ishte në pajtim me nenin 242 par. 2 të KPPK-së pasi që, i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Faktet e çështjes në raport me provat që përmban aktakuza.

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë: kallëzimi penal me numër 2021-BI-85 i datës 29.12.2021, raporti fillestar i incidentit me nr. 2021-BI-85 i datës 23.12.2021, raporti i policit hetues i datës 28.12.2021, raporti informues i datës 09.06.2021, procesverbal i marrjes në pyetje në polici i

dëshmitarit D.Sh, i datës 23.12.2021, vështrimi i fotodokumentacionit prej 1-7, procesverbal i marrjes në pyetje në polici i të pandehurit A.S, i datës 28.12.2021, informacionet për të pandehurin, dhe shkresat e tjera të lëndës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Për veprën penale Mashtrimi nga neni 323 par. 1 të KPRK-së, ligjvënësi ka paraparë mundësinë e shqiptimit të dënimit me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet, andaj gjykata vendosi që të shqiptoj dënim me gjobë në shumë prej një mijë (1000) euro, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, të cilat dënime do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, mirëpo me pëlqimi në të pandehurit dhe konform neni 44 par. 1 të KPRK-së, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muajsh, është zëvendësuar me dënim me gjobë, dhe atë në shumë prej 1800 euro, e në kuptim të neni 76 par. 2 nën par. 2.4 të KPRK-së, të pandehurit i ka shqiptuar dënim unik me gjobë në shumë prej 2800 euro (me fjalë: dymijë e tetëqind), të cilin dënim është i obliguar ta paguaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, ndërsa konform neni 43 par. 3 të KPRK-së, i pandehuri është paralajmëruar se nëse nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në afatin e caktuar, dënimin me gjobë gjykata do t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do t'i llogaritet më 20 (njëzet) euro gjobë të papaguar.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të neni 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethana rënduese për të pandehurin ka gjetur, shkallën e përgjegjësisë penale, si dhe faktin se i pandehuri e ka kryer këtë veprë me qëllim të përfitimit pasuror, i cili me qëllim që ta ngris vlerën e veturës për ta shitur kishte ulur kilometrat e kaluara, ndërsa në kuadër të rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë, pendimin e tij për kryerjen e kësaj veprë penale, premtimin që i ka bërë gjykatës se nuk do të përsërisë vepra penale, më parë i pa gjykuar, ashtu që ndaj të njëjtit shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se, edhe me këto dënime të shqiptuara ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin në rastin konkret, që i pandehuri në të ardhmen të ketë kujdes të shtuar, që të mos bien në kundërshtim me ligjin, t'i parandalojë personat e tjerë

nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par 2 nën par 2.6 dhe nenit 450 par. 1 të KPPK-së.

Vendimin që palën e dëmtuar ta udhëzoj në kontest juridiko civil, gjykata e ka bazuar në nenin 462 par. 2 të KPPK-së

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.236/2023, datë 25.03.2025

Zyrtarja Ligjore

Arta Jusufi

Gj y q t a r i

Naim Rekalju

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.